



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË ZVEÇANIT PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkujmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Vucina Jankovic, Kryetari i Komunës

Adresa: Ul. Kralja Milutina 5, Zveçan, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Zveçanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Zveçanit, të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Zveçanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Informacioni i dhënë për pasuritë fikse në PFV është jo i plotë dhe i pasaktë, sepse:

- Deri në fund të vitit 2020, Komuna nuk ka arrit të eliminojë gabimin e bërë në vitin 2019, ku Komuna kishte regjistruar gabimisht shumën prej 6,025,285€ në vend të shumës prej 60,252€. Zyrtarët komunalë, në bashkëpunim me Thesarin me dt. 22.07.2021 korrigjuan gabimin e mësipërm, duke regjistruar vlerën në SIMFK prej 60,252€.
- Një pjesë e pasurisë kapitale e financuar gjatë vitit 2020 në shumën prej 206,301€ nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë SIMFK. Gjatë muajit Korrik 2021, përfundoi procedura e regjistrimit të pasurisë së paregjistruar në vlerë prej 206,301€.
- Komuna ende nuk ka vënë në funksion sistemin e-pasurisë dhe nuk ka shpallur pasuritë nën 1,000€ në PVF. Po ashtu edhe përfitimet nga palët e treta nuk janë shpallur në PFV.

Për shkak të pamundësisë për të ndryshuar të dhënat në PVF për vitin 2020, këto çështje kanë ndikuar në Opinionin e Auditimit.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Zveçanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Zveçanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i çështjes

Gjatë vitit 2020, Komuna kishte bërë pagesa për shpenzimet e energjisë elektrike në vlerë prej 5,603€ nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, në vend që të paguante nga kategoria shpenzimeve komunale.

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Zveçanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Zveçanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Zveçanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Zveçanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga

mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komuna e Zveçanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKAsë, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalesjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja e raportuar si bazë për opinionin shpaloset si më poshtë:

Çështja B1 - Parregullsi në menaxhimin dhe shpalosjen e pasurive në PFV

Gjetja

Sipas nenit 6 të Rregullores MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Më tej, regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale mbi 1,000€ që duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-Pasuri. Komuna në PVF-ve tek neni 19.3.1 kishte paraqitur vlerën e pasurive kapitale ndërsa vlera e pasurive jo-kapitale dhe inventarët/stoqet nuk ishin paraqitur.

- Komuna në PVF-ve tek neni 19.3.1 kishte paraqitur pasuritë kapitale në vlerë prej 7,653,570€. Duhet theksuar se në shpalosjen e pasurive përfshihet një gabim teknik i bërë nga zyrtari i pasurisë duke regjistruar shumën prej 6,025,258€ në vend të 60,252.85€. Pas përpjekjeve të zyrtarëve për të korrigjuar këtë gabim përmes sistemit SIMFK dhe kërkesës të dërguara në Thesar, me dt. 22.07.2021 gabimi i mësipërm, është korrigjuar. Ky gabim ishte identifikuar në auditimin e vitit 2019.
- Gjithashtu, në PFV në nenin 19.3.1 - Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1,000 Euro), është shpalosur narrativisht shënimi se pasuritë kapitale të financuara gjatë vitit 2020 në shumën totale prej 925,850€, nuk janë regjistruar në SIMFK. Sidoqoftë, vlera e pasurive të paregjistruara në SIMFK nga investimet kapitale të financuara gjatë vitit 2020, ishte 206,301€. Ky gabim ka ndodhur për shkak të pamundësisë nga ZKF për tu qasur në sistem dhe për të verifikuar të dhënat në SIMFK. Pas auditimit, Zyrtari i pasurisë ishte në gjendje të sigurojë qasje në SIMFK dhe e ka regjistruar këtë pasuri më dt. 02.07.2021.
- Komuna ende nuk ka vënë në funksion sistemin e-Pasuria dhe nuk ka shpalosur pasuritë në vlerë nën 1,000€ në PVF.

Për më tepër sipas rregullores MF nr. 01/2017 për Raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, neni 9.6 përcakton se të gjitha pagesat nga palët e treta duhet të regjistrohen në SIMFK në harmoni me procedurën përkatëse dhe të prezantohen në pasqyrat financiare - Shënimi 13 Pagesa nga palët e treta.

Komuna nuk ka regjistruar dhe paraqitur në PVF përfitimet e pranuar në mallra, nga palët e treta, si:

- Komuna ka pranuar nga palët e treta donacione si më poshtë: me dt.29.06.2020 maska 4,800 copë, me dt.28.03.2020 janë pranuar 330 pako ushqimore dhe pajisje higjienike që ju janë ndarë qytetareve të Komunës, shtatë tableta/kompjuter që ju janë dhuruar nxënësve të shkollave. Po ashtu me dt. 16.06.2020 ka pranuar kompjuterë, telefona dhe mobilie zyre me vlerë 4,000€, për Departamentin e Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Zveçanit. Ministria për Komunitete dhe Kthimit, për nevoja të Komunës së Zveçanit, siguroi dhe shpërndau 93 paketa të ndihmës humanitare, në total 2,8 tonë tek popullata, të pranuar me dt.18.04.2020.

Për shkak të pamundësisë për të ndryshuar të dhënat në PVF për vitin 2020, këto çështje kanë ndikuar në Opinionin e Auditimit.

Kjo ka ardhur si rezultat i kontrollit të dobët në rastin e regjistrimit të pasurisë, mungesës së zyrtarit të certifikuar të pasurisë dhe mosfunksionimit të sistemit të e-pasurisë.

Ndikimi

Dobësitë e identifikuar në menaxhimin e pasurive në lidhje me mos-regjistrimin e pasurive kapitale dhe jo-kapitale, mosfunksionimi i sistemit të e-Pasurisë si dhe gabimet gjatë regjistrimit ndikojnë në raportimin e informacioneve të pasakta mbi pasurin e Komunës dhe vlerën e saj në PVF dhe raportin vjetor të buxhetit të Kosovës. Në të njëjtën kohë, rritet rreziku i keqpërdorimit dhe keq menaxhimit të tyre.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të ndërmarr masa për të siguruar se të gjitha pasuritë që Komuna ka në posedim mbi dhe nën 1,000€, janë regjistruar me kohë në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Po ashtu duhet të siguroj që është vënë në përdorim sistemi e-Pasuria.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Zveçanit në vitin 2020 ishin në vlerë prej 2,292€. Ato kanë të bëjnë me taksat administrative. Komuna gjithashtu kishte pranuar të hyra indirekte nga gjobat e trafikut në shumë prej 24,721€.

Çështja A1 - Regjistrimi i të hyrave në kodet e gabuara ekonomike

Gjetja Rregullorja financiare 03/2010 për Të hyrat, neni 12 pika 2 përcakton se “Evidentimi i të hyrave bëhet nga zyrtari i të hyrave i OB i certifikuar nga Thesari” dhe pika 8 “Të hyrat duhet të regjistrohen në SIMFK në llojin përkatës të të hyrës duke u bazuar në UNIREF, dhe planin kontabël”.

Komuna në tri nga pesë mostrat e audituar kishte regjistruar gabimisht të hyrat nga qiraja e ndërtesave të banimit në vlerë prej 645€ në kodin ekonomik 50013 (certifikata e lindjes) dhe kodin ekonomik 50016 (certifikata të tjera të qytetarëve), në vend të regjistrimit të drejt të këtyre të hyrave në kodin 50418 për të hyrat nga qiratë e ndërtesave të banimit.

Mangësitë e vërejtura në lidhje me klasifikimin e të hyrave kanë ndodhur për shkak të angazhimit të pa mjaftueshëm të zyrtarit për të hyra.

Ndikimi Mangësitë e identifikuara shpijnë në raportim jo të saktë të të hyrave sipas kodeve ekonomike dhe shpalosje të pasaktë të tyre në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A1 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të hyrat regjistrohen në kodet ekonomike përkatëse sipas Planit të kontabilitetit nga zyrtari i të hyrave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Moszbatimi i ligjit për mbledhjen e të hyrave (tatimi në pronë dhe lejet e ndërtimit)

Gjetja Neni 2 i Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme thekson qartë se çdo organizatë buxhetore duhet të mbledhë të hyra nga tatimi në pronë të paluajtshme. Gjithashtu, Ligji nr. 04/L-110 për Ndërtimin në nenet 1 dhe 2 përcakton qëllimin e lëshimit të lejeve të ndërtimit.

Kjo ka ndodhur për shkak se Komuna ende nuk ka krijuar politika të zbatimit të ligjeve dhe nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për mbledhjen e të hyrave nga këto aktivitete që kanë ndikim të rëndësishëm në nivelin e buxhetit komunal.

Ndikimi Moszbatimi i ligjeve dhe rregulloreve për mbledhjen e tatimit në pronë, lejeve të ndërtimit, tarifave dhe taksave të tjera nga Komuna pasqyron një qasje joserioze ndaj zbatimit të kërkesave ligjore në këtë fushë. Kjo rrit rrezikun e mosrespektimit të ligjeve në fuqi dhe zvogëlon nivelin e të hyrave si dhe mundësinë e financimit të projekteve nga ky burim i të hyrave.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e të gjitha kërkesave ligjeve për mbledhjen e të hyrave, të cilat kanë për qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e Komunës. Në të njëjtën kohë, Kryetari duhet të fillojë iniciimin për hartimin e rregulloreve për të gjitha tarifatat, tatimet, taksat dhe ngarkesat për shërbimet komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 1,261,531€ i cili ishte shpenzuar në masën prej 98%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit/planifikimit ishte 361, ndërsa në fund të vitit 242 ishte numri i të punësuarve. Gjatë vitit 2020, Komuna kishte shpall dy konkurse për katër punëtorë të rinj. Gjithashtu, Komuna integroi pesë punëtorë nga MAPL dhe dy nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ne testuam 51 mostra për teste substanciale në vlerë prej 27,793€ si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Parregullsi në evidentimin për prezencën e stafit

Gjetja Sipas nenit 8 të Rregullores 12/2020 për Orarin e punës dhe pushimet e zyrtareve publik – “Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtaret publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik”.

Komuna nuk posedon sistemin elektronik për ardhje-vajte në punë, mirëpo përdor lista që nënshkruhen nga të punësuarit për prezencën në punë.

Kemi identifikuar se 29 punëtor (shumica zyrtar civil që punojnë në objektin e Komunës) nga 51 rastet e audituara, nuk ishin nënshkruar në listat për vajtjen/ardhjen në punë, gjatë vitit 2020.

Kjo ka ndodh për shkak se menaxhmenti i Komunës ende nuk ka vendosur kontrolle në këtë fushë.

Ndikimi Mungesa e evidencave të prezencës së zyrtarëve në punë, paraqet kontroll të dobët mbi menaxhimin e stafit dhe mundësi për pagesën e parregullt apo fiktive, të zyrtarëve që nuk respektojnë orarin.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të marrë masat të nevojshme për të siguruar se zyrtarët nënshkruhen/evidentohen në listën e vijueshmërisë apo regjistrin elektronike, përndryshe kjo situatë paraqet shkelje disiplinore në pamundësi të kontrollit të prezencës së këtyre zyrtarëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 314,266€, nga të cilat 284,284€ ishin shpenzuar. Këto shpenzime kryesisht kanë të bëjnë me derivate, mirëmbajtje dhe riparime, mobilie, pajisje nën 1,000€, shërbime kontraktuale etj. Ne testuam shtatë mostra për teste substanciale në vlerë prej 279,390€ si dhe pesë mostra për testet e pajtueshmërisë.

Çështja B3 - Dobësi në menaxhimin e automjeteve zyrtare

Gjetja Sipas Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.2008/01 për Përdorimin e automjeteve zyrtare në Komunë, neni 1 përcakton qëllimin e përdorimit të automjeteve, ndërsa neni 2, përcakton të drejtën e përdorimit të automjeteve, duke plotësuar fletë udhëtimet e përcaktuara nga njësia e transportit. Ndërsa sipas Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 12, Kuvendi i Komunës mund të miratojë akte brenda fushës së kompetencave të tij.

Shpenzimet e karburantit për vitin 2020 ishin në vlerë prej 10,501€. Komuna kishte përgatitur një draft rregullore për përdorimin e automjeteve zyrtare, por deri në fund të vitit kjo rregullore nuk është marrë në konsideratë nga Asambleja Komunale. Lidhur me regjistrimet e kostove të karburantit, Komuna përgatiste raporte për shpenzimet mujore të karburantit nga departamentet, por ende nuk ka të dhëna të hollësishme për secilin automjet individual (pa urdhra udhëtimi, pa raporte mbi shfrytëzimin e karburantit dhe kilometrazhin).

Shkaku ishte mungesa e kontrollit për të zbatuar rregullat e përcaktuara sipas udhëzimit administrativ. Sipas menaxhmentit, për shkak të situatës me pandeminë, Asambleja Komunale nuk e ka shqyrtuar rregulloren.

Ndikimi Dobësitë në menaxhimin e automjeteve zyrtare lidhur me mos plotësimin e fletë udhëtimeve dhe mos mbajtjes së evidencave të shpenzimeve për derivate, mund të ndikojnë në shfrytëzimin jo racional të tyre, kontroll të dobët dhe menaxhim jo të mirë të shpenzimeve.

Rekomandimi B3 Kryetari, duhet të sigurojë që përdorimi i automjeteve dhe mbajtja e evidencave për përdorimin dhe shpenzimin e karburantit të bëhet sipas kërkesave të UA, si dhe të hartojë draft-rregulloren për përdorimin e automjeteve zyrtare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 373,848€, nga të cilat 337,492€ ishin shpenzuar. Këto shpenzime kanë të bëjnë me subvencione për subjektet jopublike në vlerë prej 61,501€, ndihmën financiare për të porsalindurit në komunën e Zveçanit, rehabilitimin e objekteve dhe pronave nga fatkeqësitë natyrore, dhe për subjektet publike nga buxheti i ndarë për rimëkëmbjen ekonomike në vlerë prej 275,991€. Ne testuam pesë mostra për teste substanciale në vlerë prej 279,390€ si dhe pesë mostra për testet e pajtueshmërisë.

Çështja B4 - Dobësi në monitorimin e subvencioneve

Gjetja Sipas nenit 8 dhe 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve komunale, e cila u miratua në vitin 2015, përcaktohen kërkesat për dhënien e subvencioneve, të cilat duhet të përmbajnë dokumentet në lidhje me dëshmitë të vendbanimit të përhershëm në Komunën e Zveçanit (fotokopje e letërnjoftimit ose vërtetim i autoritetit kompetent), një kërkesë me një shpjegim të hollësishëm të nevojës për të siguruar një subvencion, dëshmitë që vërtetojnë qartë pretendimet në kërkesë etj.

- Rregullorja për subvencione nuk kishte ndonjë nen që do të përcaktonte kritere të qarta për monitorimin e subvencioneve nga Komuna ose për të konfirmuar që subvencionet e dhëna ishin shpenzuar për një qëllim të caktuar. Sidoqoftë, vendimet e marra nga Kryetari i Komunës e detyrojnë përfituesin brenda 30 ditësh, të paraqesin një raport me dëshmi të përdorimit të fondeve.
- Në asnjë nga rastet e rishikuara nuk kishte raporte të përfituesve se si ishin shpenzuar fondet e marra.

Kjo ishte për shkak të mangësive në rregulloren e subvencioneve dhe kontrollit të dobët mbi dhënien dhe monitorimin e tyre.

Ndikimi Dobësitë në procesin e monitorimit të subvencioneve, si dhe mos përcaktimi në mënyrë të qartë i kritereve në rregullore, mund të shpijnë në mos përmbushjen e qëllimit për të cilin është dhënë subvencion.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë azhurnimin e rregullores së subvencioneve, si dhe të forcoj mekanizmat për monitorimin dhe menaxhimin e subvencioneve. Kontrollat e subvencioneve duhet të forcohen për të siguruar monitorimin efektiv të përdorimit të fondeve të ndara nga buxheti komunal.

2.2.5 Çështjet e ndërlidhura me shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid -19

Komuna për menaxhimin e pandemisë Covid – 19 kishte shpenzuar buxhet në vlerë prej 339,245€. Prej tyre nga paketa emergjente (00099) për paga dhe mëditje ishin shpenzuar 33,810€ dhe 29,445€ për mallra dhe shërbime (të cilat kryesisht i referohen prokurimit të preparateve kimike, furnizimeve mjekësore dhe pajisjeve tjera). Përderisa, nga paketa e rimëkëmbjes ekonomike (00098), Komuna kishte shpenzuar 275,990€ për subvencione dhe transfere.

Çështja A3 - Dobësitë në monitorimin e shpenzimeve të menaxhimit të pandemisë Covid -19

Gjetja

Në përputhje me Rregulloren e MF nr. 04/17 për kriteret, standardet, procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe Vendimin e Qeverisë nr.11/30 të dt.14.09.2020, mjetet nga paketa e rimëkëmbjes ekonomike (00098) janë buxhetuar dhe shpenzuar në vlerë prej 275,990€ në kategorinë e subvencioneve. Në thirrjen publike me dt.19.10.2020 kanë aplikuar tri OJQ, të cilat edhe kishin përfituar.

Mjetet iu janë ndarë tri OJQ-ve për zbatimin e projekteve "Reduktimi i efekteve negative të pandemisë në komunitet" në vlerë prej 90,000€, "Praesadium - Covic-19" në vlerë prej 89,995€ dhe "Covid-19 -parandalimi në bashkësinë ndër-urbane dhe pakicë" në vlerë prej 95,995.50€.

Të gjitha kontratat u nënshkruan më 01.12.2020 (ndërsa pagesat për përfituesit u paguan me dt.03.12.2020). Kontrata përcakton që përfituesi është i detyruar të realizojë projektet e përmendura brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të kontratës. Mirëpo me dt.21.01.2021 Komuna ka pranuar kërkesën nga OJQ përfituese, për vazhdimin e afatit të realizimit të projektit edhe për një muaj.

Gjithashtu Komuna ka lidhur edhe nga një marrëveshje me secilën OJQ (dt.19.02.2021) për pranimin dhe shpërndarjen këtij malli për nxënësit e shkollave (si karrige me tavolinë, tableta-kompjuter etj.). Malli është pranuar nga ana e zyrtarit të departamentit të arsimit mirëpo nuk ka dëshmi mbi shpërndarjen e këtyre mallrave apo gjurmë se si është bërë shpërndarja kush është përzgjedhur, si është përzgjedhur apo ndonjë listë të nënshkruar nga përfituesit e fundit. Vetëm tek një OJQ vlere e këtij malli ka qene 61,245€, pjesa tjetër është shpenzuar për mbulimin e operimit të OJQ-së sipas kontratës. Sipas menaxhmentit, OJQ-të në marrëveshje me drejtorët e shkollave, kanë shpërndarë mallrat dhe kanë përzgjedhur përfituesit.

Mungesa e kontrollit për ti realizuar këto projekte ishte shkak përse ka ndodh kjo situatë.

Ndikimi Dobësitë në monitorimin e subvencioneve, mungesa e dëshmive për përfituesit e fundit ndikon në mos arritjen qëllimit për të cilin është dhënë subvencioni.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj se përfituesit gjatë realizimit të aktiviteteve/projekteve ju përmbahen kritereve të përcaktuara me kontratë. Kontrollët duhet të zbatohen në të gjitha fazat e realizimit të projektit, për të arsytuar shpenzimin e parasë publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.6 Detyrimet e papaguara

Raporti për detyrimet e papaguara prej më pak se 30 ditësh në fund të vitit 2020 është 6,986€. Këto detyrime janë bartur për pagesë në vitin 2021.

Çështja C1 - Dobësi në menaxhimin e detyrimeve

Gjetja Sipas Rregullës financiare nr.01/2013/MF Shpenzimi i Parave Publike, neni 24, pika 1 dhe 1.3 të gjitha faturat duhet të pranohen duke zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit. Ndër të tjera faturat duhet të protokollohet dhe të evidentohen në librin e faturave.

Komuna nuk mban një libër protokolli për pranimin e faturave, me qëllim që të kontrolloj dokumentacionin e pranuar dhe menaxhoj faturat/obligimet për pagesë.

Deri te kjo situatë ka ardhur për shkak të kontrolleve të papërshtatshme të menaxhimit të detyrimeve në njësinë e financave komunale.

Ndikimi Dobësitë në mos mbajtjen e një libri protokolli për faturat e pranuar mund të rezultojë në mungesën e identifikimit të faturave për pagesë.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të forcoj kontrollët lidhur me menaxhimin e dokumenteve/faturave të pranuar. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen dokumentet e pranuar/faturat.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.7 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Organizatave buxhetore u kërkohet të sigurojnë që aktivitetet dhe proceset e tyre, ti nënshtrohen auditimit të brendshëm. Një sistem i duhur i auditimit të brendshëm i ndihmon menaxhmentit, të identifikojë dobësitë në menaxhimin financiar dhe kontrollin komunal. Kjo kontribuon në përmirësimin e kontrollit të brendshëm, arrijtjen e qëllimeve dhe përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Komuna.

Çështja A4 - Mos sigurimi i shërbimit të auditimit të brendshëm

Gjetja Ligji nr.06/L-021 për Kontrollin e brendshëm të financave publike dhe Rregulloren e QRK-së nr.01/2019 për krijimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, nenet 4 dhe 5 përcaktojnë funksionin dhe mënyrën e themelimit të NjAB-it. Bazuar në nenin 5 “Subjekti i sektorit publik i cili ka buxhet më pak se tre (3.000.000€) milionë euro, funksionin e auditimit të brendshëm ta ushtron përmes mënyrave tjera sipas nën paragrafëve 1.2, 1.3 dhe 1.4 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje. (themelimin e një njësi të përbashkët, apo marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të auditimit nga një subjekt i sektorit publik apo kontraktimit të një kompanie profesionale sipas kriterëve të vendosura, me miratimin/aprovimin paraprak të MF).

Komuna gjatë vitit 2020 nuk është audituar edhe pse ka dërguar një kërkesë në MF për nevojat e shërbimit të auditimit të brendshëm, derisa për periudhën 2019, është audituar nga MF.

Kjo për shkak se nuk janë bërë përpjekje për themelimin e një njësi të përbashkët, apo kontraktimit të një kompanie profesionale, sipas kriterëve të vendosura, me miratimin/aprovimin paraprak të MF.

Ndikimi Mungesa e raporteve të auditimit të brendshëm shpie në përsëritjen e vazhdueshme të dobësive në sistemet kryesore të kontrollit të brendshëm dhe menaxhmenti mund të mos jetë në gjendje të identifikojë dobësitë e kontrollit dhe të përgjigjet në kohën e duhur për t'i eliminuar ato.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se aktivitetet komunale i nënshtrohen auditimit të brendshëm për të pranuar një vlerësim të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve nga kategoritë ekonomike dhe të hyrat e mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	2,435,330.00	3,453,242.15	2,793,775.02	2,150,768.83	2,045,974.24
Grante Qeveritare - Buxheti	2,400,330.00	2,360,983.88	2,321,528.05	1,876,699.37	1,844,362.03
Financimi përmes huamarrjes	0.00	5,355.00	5,355.00	0.00	0.00
Fondi zhvillimor në mirëbesim	0.00	985,139.82	437,891.97	241,326.71	97,890.93
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	27,834.34	27,600.00	26,392.75	15,817.25
Të hyrat vetanake	35,000.00	35,000.00	1,400.00	6,350.00	0.00
Donacionet e jashtme	0.00	38,929.11	0.00	0.00	87,904.03

Buxheti final është më i lartë se ai fillestar për 1,017,912€. Kjo rritje është rezultat i mjeteve të ndara për Fondin për Zhvillim në vlerë prej 985,140€, të hyrat vetanake të transferuara nga viti paraprak në vlerë prej 27,833€, financimi i huazimit në vlerë prej 5,355€, donacionet e pashpenzuara në vlerë prej 38,929€ (Fondet e BE-së nga 2018 të cilat ishin të destinuara për shpenzimet e pagave, por këto paga ishin realizuar nga Granti Qeveritar) dhe në të njëjtën kohë duke zvogëluar Grantin Qeveritar në vlerë prej 39,345€.

Në vitin 2020, Komuna shpenzoi 81% të buxhetit final ose 2,793,775€, me një përmirësim prej 24% krahasuar me vitin 2019 (që ishte vetëm 57%). Për realizimin e buxhetit, shpjegimet për situatën aktuale janë dhënë më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	2,435,330.00	3,453,242.15	2,793,775.02	2,150,768.83	2,045,974.24
Pagat dhe mëditjet	1,523,025.00	1,261,531.03	1,241,224.12	1,135,530.58	816,765.81
Mallrat dhe shërbimet	274,283.00	314,265.63	284,283.66	228,441.96	191,426.54
Komunalitë	50,000.00	19,950.26	4,924.98	6,044.54	3,579.82
Subvencionet dhe transferet	70,000.00	373,848.14	337,492.30	72,464.96	80,678.25
Investimet Kapitale	498,480.00	1,483,647.09	925,849.96	708,286.79	953,523.82
Rezervat	19,542.00	0.00	0.00	0.00	0.00

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillesat është zvogëluar për 261,492€, buxheti final u shpenzua në masën prej 98%. Krahasuar me vitin 2019, shpenzimet për paga dhe mëditje u rritën për 105,694€ për shkak të integritimit të shtatë punonjësve, rekrutimit të katër punëtorëve, pagesës së shtesës për punonjësit shëndetësorë për menaxhim të pandemisë;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 39,983€, kjo rritje kryesisht ishte për menaxhim të pandemis COVID -19 dhe ishte shpenzuar për blerjen e tuneleve dezinfektuese, maskave mbrojtëse, dorezave, rroba higjienike, alkool, dezinfektues, mbathje mbrojtës, maska plastike, dezinfektim të ambienteve dhe rrugëve. Përkundër kësaj rritje, buxheti final në këtë kategori ishte shpenzuar 90%;
- Buxheti final për komunalitë në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 30,050€, përkundër këtij zvogëlimi ky buxhet ishte shpenzuar vetëm 25% duke pasqyruar se Komuna nuk paguan këto shërbime si, ujë, rrymë etj.;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 303,848€, kjo rritje ishte për menaxhim të pandemisë. Buxheti final për këtë kategori ishte shpenzuar 90%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 985,167€, përkundër kësaj rritjeje, vetëm 62% e buxhetit ishte shpenzuar. Ky nivel i ulët i realizimit u ndikua nga mos realizimi i buxhetit të Fondit të Zhvillimit, i cili ishte shpenzuar vetëm 44%, për shkak të vonësve në realizim të projektit. Programi i Investimeve Publike (PIP) përfshin një projekt vijues nga viti i kaluar dhe pesë projekte të reja për vitin aktual. Projektet që filluan në vitin 2020 në përputhje me dinamikën e punimeve kanë përfunduar. Kishte vonesa në ekzekutimin e punimeve, por duke pasqyruar situatën e shkaktuar nga pandemia Covid 19, kontraktorëve ju lejua afat shtesë për punime, bazuar në kërkesën për zgjatje të afatit.

Sipas buxhetit për projekte kapitale, është planifikuar realizimi i projektit: Ndërtimi i Qendrës Rinore në Zveçan - Faza II dhe ai ka përfunduar.

Gjithashtu, Komuna ka pasur bashkëfinancim të projekteve kapitale nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Zyra e Kryeministrit. Në kategorinë e bashkëfinancimit të projekteve kapitale - Asfaltimi i rrugëve të pa kategorizuara, u realizuan katër projekte, si vijon:

1. “Ndërtimi i rrugëve tranzit në drejtim të rrugës Srbovac – Valaç”, vlera totale e parashikuar e projektit është 79,604€, MZHR do të sigurojë mjete 45,000€ dhe shuma e mbetur prej 34,604€ është siguruar nga buxheti për investime kapitale i Komunës së Zveçanit. Vlera e kontraktuar është 79,526€, ku Komuna ka paguar 34,592€, ndërsa MZHR-ja 24,476€, por ka mbetur pa paguar edhe shuma prej 17,434€.
2. Rindërtimi i rrugëve në zonën qendrore të Zveçanit, vlera gjithsej e parashikuar e projektit është 79,829€, MZHR do të sigurojë 79,000€ dhe shuma e mbetur prej

829€ do të sigurohet nga buxheti për investime kapitale i Komunës së Zveçanit. Vlera e kontraktuar është 79,775€. MZHR ka paguar 78,786€ dhe Komuna ka paguar situacionin përfundimtar në vlerë prej 790.50€.

3. Asfaltimi i rrugëve të pa kategorizuara në komunën e Zveçanit (Seksioni I: Rruga lokale e pa kategorizuar në fshatin Valaç L=625.00m, b=3.00m, Seksioni II: Rruga lokale e pa kategorizuar në fshatin Srbovac L=250.00m, b=3.00m), vlera gjithsej e parashikuar e projektit është 49,985€, MAPL do të sigurojë tërë shumën nga buxheti i vitit 2020. Vlera e kontraktuar është 49,848€, por Ministria nuk e ka përmbushur detyrimin e saj, deri në fund të auditimit.
4. Ndërtimi i mureve mbrojtëse (Ndërtimi i mureve mbrojtëse të betonit të armuar nga TV Most deri te Hoteli nr. 3 (L=45m, h=3m) dhe Ndërtimi i rrethojës në rrugët hyrëse për urën Srbovac - Valaç L=120m), gjithsej vlera e parashikuar e projektit është 33,482€, Zyra për Çështje të Komunitetit (ZÇK) në Zyrën e Kryeministrit, siguroi 1,000€, dhe shuma e mbetur prej 32,482€ është siguruar nga buxheti për investime kapitale i Komunës së Zveçanit. Në fillim të vitit 2020, ZÇK-ja ka paguar shumën prej 999.60€ dhe pjesën e mbetur e ka paguar Komuna.


Lidhur me Fondin për Zhvillimin e Veriut, mjetet si të pashpenzuara u transferuan në buxhetin e Komunës së Zveçanit për vitin 2021 në vlerë prej 574,248€. Nga ky fond janë realizuar vetëm disa projekte, si:

1. Realizimi i projektit shumëvjeçar: Rindërtimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve në Zveçan - Faza II, ka vazhduar dhe është paguar situacionin i dytë në vlerë prej 75,749€, si dhe situacionin i tretë në vlerë prej 232,409€. Realizimi i këtij projekti përfundoi në Prill të vitit 2021 ku është kryer edhe pagesa përfundimtare.
2. Realizimi i projektit: Ndërtimi i rezervarit të ujit të pijshëm në Zveçan $V=2,000m^3$, vlera e kontraktuar është 459,904€. Në vitin 2020 është paguar vetëm 119,508€, për shkak të vonesës në realizimin e këtij projekti. Fondet e pashpenzuara për këto projekt kanë ndikuar që realizimi i buxhetit për investime kapitale nuk ka qenë në nivelin maksimal. Projektet janë bartur për tu realizuar në vitin 2021.


Raportimi i detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2020 është në shumën prej 2,984€. Në vitin 2020, ishin ngritur 28 padi aktive kundër Komunës së Zveçanit, nga të cilat katër ishin aktgjykime përfundimtare në vlerë prej 2,984€. Për 24 padi të mbetura në lidhje me shpenzimet e udhëtimit, shujtat e nxehta dhe pagat jubilarë, bazuar në aktgjykimet e deri tanishme, Komuna parashikon një vlerë prej 17,904€ që i ka shpalosur në PFV.

Komuna këtë vit ka shpenzuar mjetet në vlerë prej 339,245€ për menaxhimin e pandemisë. Prej tyre paga 33,810€, mallra dhe shërbime 29,445€ dhe si subvencione 275,990€ (ref. kapitullit 2.2.5).

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e realizuar ishin në vlerë 2,293€ apo afër 7% krahas planifikimit. Përveç të hyrave të prezantuar në tabelë nr.3 Komuna ka realizuar edhe të hyra indirekte nga gjobat e policisë në vlerë prej 24,721.5€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	35,000.00	35,000.00	2,292.50	1,761.50	1,034.00
Të hyrat jo tatimore	35,000.00	35,000.00	2,292.50	1,761.50	1,034.00

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit i Komunës së Zveçanit për PVF-të e vitit 2019 rezultoi me nëntë rekomandime. Komuna ka zhvilluar një Plan veprimi që përshkruan se si do të adresohen rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë të vitit 2020, dy rekomandime ishin zbatuar, një ishte në proces, katër nuk ishin zbatuar ende dhe dy konsiderohen si të mbyllura, siç tregohet në grafikun 4, më poshtë. Për një përshkrim më të detajuar të rekomandimeve dhe mënyrës se si ato janë trajtuar, shih Tabelën 4.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	PVF	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinin të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Kjo çështje do të trajtohet në Raportin vjetor të auditimit RVA.	Nuk është i aplikueshëm më.
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve për mbledhjen e të hyrave, që kanë për qëllim në radhë të parë zbatimin e kërkesave ligjore si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Njëherit duhet të inicioj pa vonesë hartimin e një rregullore të brendshme për taksat, tarifrat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike.	Rekomandimi nuk është zbatuar ende, dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të siguroj që rekrutimet e stafit bëhen sipas pozitave të aprovuara dhe në pajtim me procedurat e rekrutimit të përcaktuara me ligj.	Nuk kemi identifikuar raste të njëjta.	I zbatuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari, duhet të siguroj se të gjitha kontratat e të punësuarve janë azhurnuar sipas kërkesave ligjore si dhe pagesat në listën e pagave janë në përputhje me ato.	Nuk janë vërejtur mangësitë të ngjashme.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet pa komunalitë	Kryetari, duhet të siguroj që përdorimi i automjeteve dhe mbajtja e evidencave të tyre bëhet sipas kërkesave të UA, në të kundërtën të inicioj hartimin e një rregulloreje të brendshme për mënyrën e përdorimit të automjeteve zyrtare.	Nuk janë ndërmarr veprime nga Komuna.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari, duhet të siguroj zbatimin e plotë të rregullores për subvencione, si dhe mekanizmat për mënyrën se si do të monitorohen dhe menaxhohen subvencionet. Kontrollat mbi ndarjen e subvencioneve duhet të forcohen për të siguruar monitorim efektiv të shfrytëzimit të mjeteve të ndara nga buxheti i komunës.	Edhe këtë vit Komuna përballet me të njëjtën situatë.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherit duhet të siguroj që është vënë në përdorim e-pasuria.	Nuk janë ndërmarr veprime nga Komuna për korrigjim të PFV.	Nuk ka filluar zbatimin

8.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcoj kontrollet lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF.	Pjesërisht zbatuar, mirëpo ende nuk protokollohen faturat e pranuar.	Pjesërisht zbatuar
9.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të siguroj aprovimin e pozitive dhe të ndërmerr masa lidhur me themelimin dhe funksionimin e NjAB-së, për të siguruar mbështetje në menaxhimin e fushave me rrezik dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit.	Raporti është bërë nga Ministria e Financave për vitin 2019 dhe Komuna nuk obligohet të themeloj NjAB.	Nuk është aplikueshëm më

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të ndërmerr masa për të siguruar se të gjitha pasuritë që Komuna ka në posedim mbi dhe nën 1,000€, janë regjistruar me kohë në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Po ashtu duhet të siguroj që është vënë në përdorim sistemi e-Pasuria.
2.	Të hyrat	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të hyrat regjistrohen në kodet ekonomike përkatëse sipas Planit të kontabilitetit nga zyrtari i të hyrave.
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e të gjitha kërkesave ligjeve për mbledhjen e të hyrave, të cilat kanë për qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e Komunës. Në të njëjtën kohë, Kryetari duhet të fillojë iniciimin për hartimin e rregulloreve për të gjitha tarifrat, tatimet, taksat dhe ngarkesat për shërbimet komunale.
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të marrë masa të nevojshme për të siguruar se zyrtarët nënshkruhen/evidentohen në listën e vijueshmërisë apo regjistrin elektronik, përndryshe kjo situatë paraqet shkelje disiplinore në pamundësi të kontrollit të prezencës së këtyre zyrtarëve.
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari, duhet të siguroj që përdorimi i automjeteve dhe mbajtja e evidencave për përdorimin dhe shpenzimin e karburantit të bëhet sipas kërkesave të UA, si dhe të hartoj draft-rregulloren për përdorimin e automjeteve zyrtare.
6.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë azhurnimin e rregullores së subvencioneve, si dhe të forcoj mekanizmat për monitorimin dhe menaxhimin e subvencioneve. Kontrollat e subvencioneve duhet të forcohen për të siguruar monitorimin efektiv të përdorimit të fondeve të ndara nga buxheti komunal.
7.	Covid - 19	Kryetari duhet të siguroj se përfituesit gjatë realizimit të aktiviteteve/projekteve ju përmbahen kriteret e përcaktuara me kontratë. Kontrollat duhet të zbatohen në të gjitha fazat e realizimit të projektit, për të arsyetuar shpenzimin e parasë publike.

8.	Obligimet papaguara	e	Kryetari duhet të forcoj kontrollet lidhur me menaxhimin e dokumenteve/faturave të pranuar. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen dokumentet e pranuar/faturat.
9.	Auditimi Brendshëm	i	Kryetari duhet të sigurojë se aktivitetet komunale i nënshtrohen auditimit të brendshme për të pranuar një vlerësim të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Luljeta Morina, Udhëheqëse e Auditimit



Svetlana Perović, Udhëheqëse e ekipit



Stana Dancetović, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

KOMUNA ZVEÇAN

ZVEÇAN

Ul.Kralja Milutina bb.tel.(028)664-726, fax(028)664-728

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Komunës së Zveçan**, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe (kjo pikë përshtatet nga entiteti)
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Vučina Jankovič,
Kryetari i Komunës Zveçan



Data: 23/07/2021

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁷ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

I kualifikuar,

I kundërt, ose

Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

të përfshihet menjëherë pas opinionit;

të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;

të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe

të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.